



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 14.2.2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla, N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Dimal Basha, Doarsa Kica- Xhelili, Hajdar Beqa, Blerta Deliu- Kodra Besnik Tahiri dhe Erxhan Galushi.

Munguan: Ljubinko Karaxhiq dhe Artan Abrashi.

Mbledhjen e kryesoi: Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Detrina Alishani, KK; Alban Nasufi, asistent i kryetarit; Bleona Marmullaku, KDI; Haxhi Gashi, EU-CC Project 2; Dr. Kershu Beushue dhe Arta Cubaj, CC 2 TL; Sanije Berisha, OSBE; dhe Arjana Berisha, Kallxo.com.

Stafi mbështetësi Komisionit: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2022;
3. Shqyrtimi në parim i Projektkodit Civil të Republikës së Kosovës nr.08/L-124;
4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile;

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale;
7. Shqyrtimi i shkresës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
8. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2022;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim planin e punës së Komisionit për vitin 2022 dhe tha se Plani i Punës përfshinë agjendën legjislative për vitin 2022 si dhe projektligjet e trashëguara nga viti i kaluar. Referuar programit legjislativ për vitin 2022, figuron edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Personat e Zhdukur, i cili nuk është përfshirë në planin e punës meqë i përket në bazë të fushëveprimtarisë Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Ministria e Drejtësisë do të procedojë 14 projektligje gjatë vitit 2022, ndërsa 14 projektligje janë të trashëguara nga viti i kaluar. Sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve, theksoi se ka propozuar dy ligje dhe se janë të hapur për propozime të reja. Ligjet e propozuara janë Ligji 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ligj për zbatimin e të cilit nuk ka shumë informacione dhe Ligji 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, ligj tejet i rëndësishëm që tashmë dihet që nuk ka gjetur zbatim dhe me këtë rast mund të mësohen pengesat që janë hasur.

Driton Selmanaj, në lidhje me monitorimin e zbatimit të ligjeve, theksoi se Ligji për mbikëqyrjen elektronike të personave është miratuar vonë dhe shprehu dilemat nëse monitorimi i zbatimit të këtij ligji do të jetë i frytshëm, përpos pyetjeve eventuale për plotësimin me legjislacion sekondar. Ndërkohë, propozoi të monitorohet Ligji për Noterinë, për të cilin ka shumë ankesa nga qytetarët.

Kryetari, theksoi se pajtohet me propozimin e deputetit Selmanaj dhe se mund të përfshihen dy ligjet.

Hajdar Beqa, tha se monitorimi i dy ligjeve në vitin 2021 rezultoi me shumë sukses dhe theksoi se pajtohet me propozimin e deputetit Selmanaj mirëpo Ligji për Noterinë mund të inkuadrohet dhe përgjatë vitit, pas votimit të planit të punës. Po ashtu, tha se do duhej që në planin e punë të përfshihet edhe vizita në Shërbimin Korrektues.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, në fjalën e tij ngriti disa çështje. Së pari potencoi se Kushtetuta ka mangësi elementare dhe është koha për korrigjime për shkak të problemeve substanciale. Gjithashtu, i propozoi Komisionit rishikimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit që është pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, përmes përfshirjes së aspekteve përtej çështjes së ngritur nga pala për pensionet suplementare, në kundërshtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Më tej njoftoi se nisma e deputetëve për amendamentimin, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për të drejtat e ish- të burgosurve politikë është në përfundim e sipër, duke thënë se do të adresohen edhe disa çështje jo shumë problematike që kanë mbetur pa u përfshirë. Ndër aktivitete të tjera, Hyseni –Kaloshi propozoi përfshirjen e vizitave në qendra korrektuese dhe rritjen e tryezave për probleme të ndryshme me shtetet fqinje si dhe shtetet me përvojë më të përparuar.

Driton Selmanaj, lidhur me çështjen e ngritur nga deputeti Hyseni – Kaloshi për Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, tha se Ligji ka trajtuar dy çështje kryesore, pensionet suplementare dhe imunitetin e deputetëve, që janë rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese. Duke qenë një ndër iniciatorët e çështjes së ngritur në Gjykatë Kushtetuese, tha se nuk mund të ketë pension suplementar pa fond suplementar. Kjo çështje duhet rregulluar me nismë legjislative.

Besnik Tahiri, potencoi se duhen të marrin iniciativën të trajtojnë këtë Ligj dhe për shkak të zhvlerësimit të zyrtarit publik ndër vite në publik, kohët e fundit dhe të deputetit. Ai tha se ka modele të mira për të mësuar në lidhje me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputeti në vende të rajonit dhe vende ku Kosova aspiron të jetë, të cilat duhen shfrytëzuar.

Dimal Basha, theksoi se çështja e deputetit mund të rregullohet me Ligjin për Kuvendin dhe u pajtua me deputetin Tahiri se perceptimi për deputetin në publik ka rënë shumë. Si vizitë në kuadër të planit të punës, Basha propozoi vizitën në KPK dhe KGJK, për të diskutuar mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe problemet e tyre.

Blerta Deliu – Kodra, tha se Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dallon substancialisht me Ligjin për Kuvendin, si dy institucione me përgjegjësi të ndara. Duhet treguar kurajo dhe guxim politik në mënyrë që të forcojmë mekanizmat ligjor të ligjvënësit, duke rritur shkallën e demokracisë dhe të përfaqësimit.

Hajdar Beqa, tha se përkrah iniciativën e deputetit Hyseni – Kaloshi, duke pasur kujdes që të vepronet në vijë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe vlerësoi që kjo iniciativë duhet të inkuadrohet në agjendë për pjesën e dytë të vitit. Sa i përket vizitave propozoi të vizitohet Agjencia për Ndihmë Juridike falas për të parë kushtet në të cilat punojnë. Tek iniciativat ligjore duhet treguar vullnet politik për padrejtësinë ndaj kategorive që kanë lëshuar punën në vitet e 90-ta në sistemin paralel, tha Beqa dhe vazhdoi se janë pikërisht ata që duhet të gëzojnë të drejtën e pensionit. Gjithashtu theksoi se, edhe pse nuk janë Komision funksional në lidhje me këtë çështje megjithatë mund të marrin iniciativë të tillë dhe ta inkuadrojnë në planin e punës për pjesën e dytë të vitit.

Doarsa Kica – Xhelili, theksoi se me çështjen e fundit të ngritur nga deputeti Beqa është duke u marrë dhe Komisioni për Administratë Publike, duke qenë se është programin legjislativ. Po ashtu, tha se pajtohet me propozimet për vizita në KGJK dhe KPK, për të mësuar më shumë për hapat që KGJK-ja ka ndërmarrë për funksionalizimin e Gjykatës Komerciale. Lidhur me iniciativën e propozuar për Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, deputetja theksoi se konsideron që tani nuk është momenti për të ndërmarrë këtë iniciativë, për të rregulluar pozicionin e deputetit, para rregullimit të Ligjit për Paga. Sa i përket diskursit të krijuar, tha se në të kanë kontribuar paksa edhe deputetët si dhe partitë politike, me diskutime të shumta të politizuara dhe diskutime të pakta përmbajtjesore në seanca plenare.

Hajdar Beqa, potencoi se me këtë iniciativë nuk po pretendohet rregullimi i pagave, por të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Në këtë kontekst kjo iniciativë mund të lihet për pjesën e dytë të vitit, pas kalimit të Ligjit për Paga.

Besnik Tahiri, potencoi se do të ishte më mirë që kjo iniciativë të merrej nga Komisioni me përfaqësim ndërpartiak, në të kundërtën do ta marrë grupi i tij parlamentar. Ndërkaq, tha se deputeti sot është pa të drejta, pa mbrojtje ligjore, i përçmuar qoftë edhe nëse krahasohet rroga e deputetit me rrogën e një profesionisti në sektorin privat.

Doarsa Kica – Xhelili, tha se është shumë dakord me deputetin Tahiri, mirëpo ka çështje më me prioritet për qytetarët që duhet të përfundojnë para nismës në fjalë dhe agjenda mund të përditësohet në qershor.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, vlerësoi se Ligji është pezull pa të drejtë sepse të kontestueshme në Ligj kanë qenë dy nene, që do të mund të ishin eliminuar apo amendamentuar. Pasi përfundon mandati i deputetit, ndodh që i merret gjithçka, përfshirë pasaportën, përderisa është e ditur që me përfundimin e mandatit nuk përfundojnë përgjegjësitë e deputetit, aktivitetet si dhe ftesat në konferenca dhe organizime të ndryshme.

Kryetari, theksoi se plani është shumë dinamik dhe mospërfshirja e Ligjit sot nuk nënkupton mospërfshirjen më vonë. Kryetari potencoi që është për forcimin, rregullimin dhe qartësimin e pozicionit, mirëpo, kur flitet për të drejtat flitet për privilegje dhe në këto rrethana mund të ndikojë në përkeqësimin e statusit të deputetit për shkak të ndjeshmërisë së krijuar në publik andaj dhe le të lihet për 6 mujorin e dytë.

Hajdar Beqa, tha se nëse një çështje rregullohet me ligj, Kryesia e Kuvendit nuk mund të bëjnë deklarata populiste për kalkulime të votave ditore. Do të ishte mirë që Ligji të inkuadrohet për pjesën e dytë të vitit dhe të diskutohet në publik.

Driton Selmanaj, theksoi se e mira në këtë çështje është që ka konsensus, mirëpo kur flitet për këtë ligj nuk duhet menduar vetëm për privilegje dhe të drejta. Në këtë kontekst për shkak të ndjeshmërisë së tematikës mund të mos futet sot në plan të punës, mirëpo ky aspekt duhet rregulluar gjithsesi.

Kryetari, theksoi se barra e hartimit të Ligjit, bie tek deputetët pasi që do të ishte pak e pakuptimtë të kërkohet nga Qeveria të hartojë Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Ndërkaq saktësoi se propozimet ishin Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Noterinë; Vizita në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës; Vizita në burgje; Tryezë ose konferencë pas muajit prill. Por lidhur me tryezat e propozuara nga deputeti Hyseni – Kaloshi, tha se ndoshta tani mund të mos specifikohet tema, mirëpo mund të organizojmë konferencë 1-2 ditore për Vetting-un me të ftuar, ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues nga Shqipëria.

Driton Selmanaj, theksoi që deputeti Hyseni – Kaloshi ka pasur pothuajse propozimin e njëjtë dhe vitin e kaluar andaj është mirë që këto propozime të mos mbesin vetëm si ide. Do të ishte mirë të organizohet diçka regjionale, tema qoftë Vetting-u, deklarimi i pasurisë, qoftë dhe konfiskimi.

Hajdar Beqa, propozoi muajt prill-maj për këtë organizim.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 9 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Të miratohet Plani i Punës së vitit 2022 i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ndryshimet e propozuara.

3. Shqyrtimi në parim i Projektkodit Civil të Republikës së Kosovës nr.08/L-124

Kryetari, paraqiti për shqyrtim në parim projekt-kodin civil të Republikës së Kosovës nr. 08/L-124 dhe njoftoi se ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu ka konfirmuar pjesëmarrjen në mbledhjen e kaluar, që u anulua për shkak të seancës plenare dhe sot nuk ka mundur të jetë e pranishme në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar Projektkodin Civil. Gjithashtu kryetari njoftoi se të pranishëm janë përfaqësuesit e projektit ndërkombëtar që kanë kontribuar dhe mbështetur Projektkodin. Për shkak të vëllimit të projektkodit është e pamundur që diskutimi të shteret sot andaj do të ishte më e arsyeshme të organizohet një dëgjim publik i gjatë me pjesëmarrjen e ministres së Drejtësisë.

Kryetari njoftoi se projekti ndërkombëtar përfundon më 30 prill, andaj kërkoi konsideratë që Projektkodi të mos vonohet dhe të procedohet sot, në mënyrë që dhe përfaqësuesit të mund të jenë pjesë e dëgjimeve publike.

Hajdar Beqa, tha se projektkodi është mjaft mirë i strukturuar dhe mund të konsiderohet si menjëherë pas Kushtetutës, pasi rregullon shumë çështje dhe falënderoi ekspertët që kanë punuar në Projektkod e veçanërisht për kontributin e madh, Projektin e BE-së.

Driton Selmanaj, tha se është bërë punë e madhe dhe falënderoi Zyrën e BE-së dhe sidomos profesorin Haxhi Gashi për kontributin e dhënë. Deputeti Selmanaj pati një sërë dilemash si vijon, nëse në parim lejohet martesë me gjini të njëjtë, pse duhet të rregullohet me ligj të veçantë dhe jo me Kod? A stimulohet divorci me ndarjen 50/50 të pasurisë pavarësisht kontributit dhe ku janë marrë këto praktika dhe pse është e mirë për Kosovën? Pse është hequr martesë nga mosha 16 vjeçare me leje të prindërve? Pse janë lënë kontratat fushën e marrëdhënieve tregtare të rregullohen me Kod tjetër të fushës tregtare? A ka nismë dhe çfarë do të bëhet me çështjet e procedurës civile si dhe a do të ketë Kod të procedurës civile? Deputeti theksoi se dilemat e tij të shprehura i përkasin vetëm të drejtës familjare, pa hyrë në të drejtat tjera po aq të rëndësishme. Selmanaj tha se Projektkodi Civil është prej materieve më të rëndësishme që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës, që përmban shumë risi për Kosovën dhe ndonjëherë duhet sakrifikuar kohën për substancën, për një rregullim kaq të rëndësishëm që do gjej përdorim të përditshëm në jetën e çdo qytetari.

Kryetari, tha se është dakord që Qeveria do duhej të ishte e pranishme për ta prezantuar Projektkodin dhe për tu përgjigjur në pyetjet e deputetëve. Megjithatë theksoi se kjo nuk është mënyra e vetme për të marrë përgjigje, meqë deputetët do të kenë mundësi t'i shtrojnë këto çështje në seancë dhe dëgjim publik, andaj dhe nuk duhet vonuar procesi.

Driton Selmanaj, theksoi se kryetari po flet për procedura që hyjnë në funksion pas futjes së Projektkodit në procedurë dhe se është i interesuar që këto çështje të diskutohen para futjes në procedurë.

Besnik Tahiri, tha se pajtohet me deputetin Selmanaj dhe se vlerëson punën e shkëlqyeshme të Projektit të BE-së. Ai theksoi se miratimi i Projektkodit Civil është një hap i madh, për të cilin po punohet nga viti 2014. Deputeti theksoi se është tejet i rëndësishëm ballafaqimi me ministren Haxhiu, qoftë dhe sot ose nesër para se Projektkodi të hyj në procedurë. Në dëgjime publike do të jenë të përfshirë aktorë të ndryshëm dhe nuk do të jetë i njëjtë rol i deputetëve, përfshirë kohën e limituar që ke, për të mos shpenzuar kohën e të pranishmëve tjerë. Deputeti Tahiri, pyeti nëse mund të paraqes në Kryesi çështjen e diskutuar lidhur me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputeti.

Deputetët e Komisionit pohuan, mund ta ngre si çështje, por jo në emër të Komisionit.

Doarsa Kica – Xhelili, theksoi se Projektkodi është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet tjera. Projektkod ka çështje me të cilat nuk pajtohet pasi që nuk mendon që janë praktike dhe mund

të shkaktojnë probleme për të cilat po të ishte dhe ministrja e drejtësisë do vazhdonte të mbajë po të njëjtin qëndrim.

Hajdar Beqa, theksoi se mungesa në shqyrtim të një Projektkodi kaq të rëndësishëm tregon papërgjegjësinë e ministres. Ka çështje që duhen shtuar përfshirë dhe disa ndryshime të bëra. Nëse sot e përkrahim në parim Projektkodin, nuk do të thotë që do ta përkrahim në mes të dy leximeve si dhe vlerëson se mungesa e ministres është e qëllimshme për t'i ikur përballjes me deputetët lidhur me lëshimet dhe ndryshimet që janë bërë në Projektkodin Civil. Deputeti potencoi që grupi parlamentar PDK e përkrah në parim Projektkodin Civil, megjithatë para votimit në Komision duhet të organizohet një takim me ministren.

Kryetari, propozoi që pas miratimit në parim të Projektkodi Civil të mbahet një takim gjatë javës me ministren e drejtësisë.

Blerta Deliu – Kodra, tha se kodifikimi i të drejtës civile po ndodhë për herë të parë në Republikën e Kosovës, natyrisht që ministrja do duhej të ishte e pranishme dhe mosprezenca tregon papërgjegjësi. Është e kuptueshme që ajo nuk do të mund t'i jepte përgjigje shumë pyetjeve të deputetëve, mirëpo ka ndryshime për të cilat do duhej dëgjuar për çështje tejet të rëndësishme si trashëgimia, martesat e gjinisë së njëjtë.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, u pajtua se do ishte mirë të shkëmbejnë pikëpamjet me përfaqësues të Qeverisë mirëpo projektkodi është në shqyrtim të parë dhe duke marrë parasysh gamën e gjerë të ligjeve të parapara, vonesat e tilla do të ndikojnë në pamundësimin e përmbushjes së planit të punës së sapo miratuar.

Driton Selmanaj, tha se më shqetësuese është se si Komisionin më kryesor të Kuvendit po e shndërroni në Komision procedural. Sot do duhej që Projektkodi të diskutohej 5-6 orë dhe tani po pajtohemi që të mos diskutohet fare. Natyrisht që mungesa e ministres nuk do të ndikojë në votë të një Projektkodi kaq të rëndësishëm dhe tha se po i mbyll sytë vetëm për hir të kolegjalitetit mes tyre.

Doarsa Kica – Xhelili, theksoi se Qeveria është irrelevante në kontekstin se nuk sheh problem në aspektin për të cilin janë të thirrur sot. Le ti mbetet faturimi i mungesës së rëndësishme në këtë mbledhje Qeverisë, mirëpo, bëhet fjalë për shqetësime të shumta që nuk do të mund t'i arsyetonin dhe diskutimet që nuk do të ezauroheshin dot në kuadër të shqyrtimit në parim. Nuk duhet lejuar që qytetarët të jenë ata të cilët do të pësojnë nga vonesat e mundshme, si rezultat i ministrave të papërgjegjshëm që mund të shfaqen në të ardhmen.

Driton Selmanaj, tha se deputetja Kica – Xhelili duke theksuar shqetësimet e shumta që ka për Projektkodin vetëm që i krijon më shumë dilema dhe potencoi që ndoshta të gjitha këto do mund të adresoheshin nga ministrja dhe do të ishte determinuese për votën e tij.

Kryetari, pyeti nëse do ta shtyjë për javën e ardhshme, në mënyrë që ministrja ta prezantojë Projektkodin apo nëse do të futet sot në procedurë me mundësi të takimit të veçantë me ministren ose dëgjim publik?

Dimal Basha, theksoi që debati duhet të ndodhë dhe propozoi që të shteret në dëgjime publike.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, tha se në këtë fazë duhet të analizojnë nëse projektkodi është i shqyrtueshëm dhe nëse i përmbush kriteret kryesore, ana funksionale vjen pas futjes në procedurë në shqyrtim dhe mbetet të punohet bashkërisht.

Hajdar Beqa, tha se opozita pajtohet me miratimin e Projektkodit në parim për të mos vonuar procesin dhe nëse votohet në parim Projektkodi do të votohet për hir të kolegjalitetit, ndryshe nuk do duhej kjo pikë të diskutohej fare.

Driton Selmanaj, tha se mund të bëjnë kompromis për votimin në parim sot dhe mbajtjen e një takimi të veçantë me ministren, para leximit të parë.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se me 7 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim, Projektkodit Civil i Republikës së Kosovës nr.08/L-124.

4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;

Kryetari, njoftoi se Komisioni për Legjislacion më 24.1.2022, ka dërguar Raportin me amendamente për vlerësim në Komisionet e Përhershme. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere në mbledhjen e mbajtur më 2.2.2022 ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajë implikime buxhetore shtesë. Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjen e mbajtur më 8.2.2022 ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim brenda afatit të përcaktuar me nenin 57, paragrafi 8 i Rregullores së Kuvendit nuk e ka shqyrtuar Raportin me amendamente.

Kryetari konstatoi, se në pajtim me nenin 57, paragrafi 9 i Rregullores së Kuvendit janë plotësuar kushtet që Kuvendit t'i rekomandohet për lexim të dytë Projektligji nr.08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar me amendamentet e propozuara.

Meqë, nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në lexim të dytë Projektligjin nr. 08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe tha në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente për Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile dhe theksoi se grupi punues e ka vlerësuar lartë projektligjin si të hartuar shumë mirë dhe ka bërë dy amendamente teknike

Meqë, nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratojë në parim Projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe fjalën deputetes Blerta Deliu – Kodra, në cilësi të kryesueses së grupit të punës.

Blerta Deliu – Kodra, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe theksoi se lidhur me projektligjin, grupi punues ka mbajtur një takim me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë. Ajo shtoi se grupi punues gjithashtu ka vlerësuar projektligjin si të hartuar mjaft mirë dhe ka nxjerrë vetëm një amendament teknik.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, pati vërejtje për procedurën e posaçme që po zhvillohet vetëm për heqjen e fraksionit dhe theksoi se duhet gjetur mënyra se si kjo të bëhet si pjesë e procedurës praktike.

Driton Selmanaj, u pajtua me deputetin Hyseni – Kaloshi dhe tha se mbase duhet dërguar një shkresë Ministrisë së Drejtësisë, letër në emër të Komisionit në mënyrë që çështjet e tilla teknike t'i rregullojnë përmes Zyrës për Standardizim.

Kryetari, potencoi se problemi është i njëjtë, por ka qasje të ndryshme si të adresohet. Sado që të jetë projektligji i mirë, mund të ketë lëshime të tilla teknike, prandaj dhe mund të komunikohet me Qeverinë dhe në të njëjtën kohë të shikohet për mënyra të rregullimit përmes trupave të Kuvendit që këto përmirësime të mos shndërrohen në amendamente.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, tha se Zyra Ligjore mund të ketë një ekip të posaçëm për lekturë.

Pasi nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji dhe amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i shkresës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas

Kryetari, paraqiti për shqyrtim shkresën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe njoftoi se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ka dërguar një shkresë që e kanë pranuar të gjithë deputetët, shkresë që kërkon sqarimin e mandatit të anëtares së Këshillit, znj. Hidajete Vokshi, e cila është emëruar nga Kuvendi i Kosovës me datën 29.2.2019, si anëtare e Këshillit me mandat 3 vjeçar. Nga 7 anëtarë sa duhej të zgjidheshin është zgjedhur vetëm znj. Vokshi, ndërsa 6 anëtarët e tjerë, Kuvendi i ka zgjedhur më 16.10.2020, me ç' rast dhe është funksionalizuar Këshilli. Deri me datë 16.10.2020, znj. Hidajete Vokshi nuk e ka ushtruar funksionin e saj si anëtare, në mungesë të anëtarëve të tjerë andaj dhe në shkresë është kërkuar që mandati i znj. Vokshi të fillojë të numërohet nga data që janë zgjedhur 6 anëtarët e tjerë dhe është funksionalizuar Këshilli. Kryetari, theksoi se ligjërisht nuk mund ta bëjnë këtë, pasi që vendimi i Kuvendit fillon të rrjedhë nga momenti i miratimit të tij, pavarësisht jofunksionalitetit të Këshillit.

Driton Selmanaj, ngjashëm si me deputetin, që mandati i fillon me dhënien e betimit në Kuvend pas zgjedhjes dhe në këtë rast duhet llogaritur mandati i saj nga momenti i konstituimit, kur është bërë fuqiplotë Këshilli. Deputeti Selmanaj shton se znj. Vokshi 1 vit e gjysmë nuk ka marr pagë dhe nuk i ka realizuar të drejtat e saj me faj të Kuvendit, pasi nuk ka arritur t'i zgjedh 6 anëtarët e tjerë.

Hajdar Beqa, theksoi se anëtarja e Këshillit nuk e ka filluar punën pa fajin e saj dhe duhet marrë një vendim meritor në Komision, po ashtu duke marrë dhe opinionin e Zyrës Ligjore të Kuvendit. Beqa shtoi se vendimi i Kuvendit nuk e potencon strikt se kur i përfundon mandati, por thotë 3 vjet, andaj dhe znj. Vokshi duhet të gëzojë mundësinë të veprojë 3 vjet me mandatin e saj.

Kryetari, tha se pajtohet me kërkimin e opinionit ligjore nga Zyra Ligjore dhe theksoi se ka vendim të Kuvendit me datën e zgjedhjes së znj. Vokshi dhe arsyeja pse nuk është kompensuar qëndron në sistemin e kompensimit përmes mëditjeve me honorarë të pjesëmarrjes në mbledhje.

Doarsa Kica – Xhelili, tha se pajtohet me kërkimin e opinionit ligjor dhe theksoi që do ishte mirë se duke qenë se ka pamundësi objektive të kuorumit, nuk ka qenë me zgjedhjen e tyre të mos mbahen mbledhjet dhe vet kompensimi nuk ka ardhur si rezultat i zgjedhjes së saj ose jo, por si pamundësi objektive. Pra, të sqarohet aspekti i pamundësisë objektive, se a kalkulohet për këto arsye e emëruar dhe në detyrë edhe pse nuk e ka pasur mundësinë ta kryej atë detyrë, që mos të krijohet precedent, se ti e ke kuorumin, por ata vet nuk caktojnë mbledhje, rrjedhimisht mundesh të mos paguhen për çfarëdo arsye dhe të nënkuptohet, që e kanë mbajtur mandatin. Pra vetëm ta bëjmë diferencën, të shtrohet si pyetje për sqarim.

Pas diskutimeve anëtarët e komisionit u pajtuan, që të kërkojnë opinion ligjor në lidhje me vazhdimin e mandatit të anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

8. Të ndryshme

Kryetari, theksoi se me rastin e vizitës së Komisionit për Legjislacion në Shqipëri, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë janë pajtuar për forcimin e bashkëpunimit në mes të dy komisioneve. Pas komunikimit me kryetaren e Komisionit për Çështjet Ligjore, kryetari njoftoi se janë dakorduar për t'i ftuar për vizitë në Kosovë, me datën 11 mars. Vendimi i sotëm i Komisionit duhet të përmbajë masën e shpenzimeve që do t'i mbulojë Kuvendi i Kosovës, për të cilat kryetari propozoi të përfshijnë vetëm drekat dhe darkat. Ai njoftoi se deputetët do të vijnë me datën 10 mars, takimi do të ndodhë me 11 mars, si dhe me 12 mars do të bëhen vizitat e mundshme në Prekaz, në Burgun e Dubravës, aktivitete që do të vendosen në koordinim me ta.

Hajdar Beqa, tha se do ishte mirë që të kenë një agjendë, marrë parasysh pritjen e shkëlqyeshme që e kanë bërë ata, të kenë koordinim, në mënyrë që të organizojnë një pritje po ashtu të mirë.

Kryetari, theksoi se do të kenë një agjendë të harmonizuar pas koordinimit për aktivitetet.

Pasi nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V e n d i m

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, më 11 mars 2022, pret delegacionin e Komisionit homolog nga Republika e Shqipërisë.

Komisioni vendosi të shtrojë drekë dhe darkë pune, për delegacionin gjatë realizimit të agjendës së paraparë.

Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa për ekzekutimin e pagesës për shpenzimet për drekë pune për datën 11 mars 2022.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rustemi,
Kryetari i Komisionit,
